



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT "SHPRESA PËR NDRYSHIM", (SHN) PËR  
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE  
TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 10.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

**OBJEKT:** Për regjistrimin e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim" (SHN), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**Baza Ligjore:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 65 i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimi i KQZ-së Nr. 32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e Koalicioneve Zgjedhore në KQZ".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**VËREN**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019 , datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 ka caktuar datën 30 Qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në mbështetje të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, Partia Aleanca Kuq e Zi me Kryetar znj. Lumturi Ratkoceri, Partia Bashkimi Liberal Demokrat me Kryetar z. Arian Starova, Partia Demokracia e Re Europiane me Kryetar z. Koçi Tahiri, Partia Aleanca Popullore me Kryetar z. Artur Dojaka, Partia Balli Kombëtar me Kryetar z. Adriatik Alimadhi, Partia Emigracionit Shqiptar me Kryetar z. Kostaq Papa, Partia Ora e Shqipërisë me Kryetar z. Zef Shtjefni.



**Nr. 273 i Vendimit    Data 10.05.2019 e Vendimit    Ora 11:00 e Vendimit**

Për regjistrimin e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim" (SHN),  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë respektivisht regjistrimin e këtyre partive si subjekte zgjedhore me vendimet, nr.203, datë 23.04.2019, nr.170 datë 16.04.2019, nr.109, datë 27.03.2019, nr.232, datë 27.04.2019, nr.226, datë 27.04.2019, nr.39, datë 11.03.2019, nr.151, datë 11.04.2019.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit "Shpresa për Ndryshim" (SHN), është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni. Në kërkesë është pasqyruar emri i koalicionit "Shpresa për Ndryshim" shkronjat nistore (SHN), mënyra e paraqitjes së kërkesave të koalicionit për regjistrimin e kandidatëve sipas përcaktimeve të bëra në Kod dhe aktet e KQZ-së, emri e mbiemri i personit i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe VNV.

Në marrëveshje është përcaktuar se z. Lumturi Ratkoci autorizohet për të përfaqësuar koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit. Gjithashtu marrëveshja ka autorizuar z. Erion Softa, të paraqes kërkesën në KQZ, për regjistrimin e koalicionit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 7 partitë e sipërcituara është në përputhje me nenin 65, te ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe me vendimin të KQZ nr. 32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ",

#### **VENDOSI:**

1. Të regjistrojë Koalicionin "Shpresa për Ndryshim" (SHN), si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:
  - 1- Partia Aleanca Kuq e Zi;
  - 2- Partia Bashkimi Liberal Demokrat;
  - 3- Partia Demokracia e Re Europiane;
  - 4- Partia Aleanca Popullore;
  - 5- Partia Balli Kombëtar;
  - 6- Partia Emigracionit Shqiptar;
  - 7- Partia Ora e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

